



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 28

Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302

Prishtinë, më 5 prill 2016, në orën 11:00

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Flora Brovina, Njomza Emini, Fikrim Damka, Hatim Baxhaku dhe Adem Hoxha.

Munguan: Fadil Beka, Besa Baftiu, Time Kadrijaj dhe Shukrije Bytyçi.

Pjesëmarrës të tjerë: Saniye Berisha, OSBE; Blerta Bejtullahu, EUSRIEU dhe mediat.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Flora Brovina, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

REND I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura, më datë 9.3.2016 dhe 15.3.2016;
3. Diskutimi për projektligjet në procedurë;
4. Përzgjedhja e ekspertit për projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04 / L -054, për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre;
5. Të ndryshme.

Kryetarja e Komisionit, Flora Brovina, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura, më datë 9.3.2016 dhe 15.3.2016

Kryetarja, konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, miratoi procesverbalet e mbledhjes së Komisionit, të mbajtura më 9.3.2016 dhe 15.3.2016, pa vërejtje.

3. Diskutimi për projektligjet në procedurë

Kryetarja— Si Komision, kemi vendosur në përshpejtimin apo intensifikimin e takimeve për shqyrtimin e projektligjeve, të cilat janë në procedurë. Deri me tani, është mbajtur dëgjimi publik për projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, ku në këtë dëgjim ka pasur një pjesëmarrje mjaft të mirë dhe i kemi dëgjuar vërejtjet apo rekomandimet e tyre, lidhur me këtë projektligj. Sigurisht, sugjerimet apo rekomandimet e tyre do të trajtohen në grup punues. Unë kam pasur një takim me disa familjarë të personave me autizëm, të cilët kanë kërkuar që të jenë pjesë e këtij projektligji, sa i përket përfitimit të përcjelljes së këtyre personave, derisa fëmija të shkojë në shkollë, qoftë në aftësim apo riaftësim për punë. Besoj se kjo mundësi do të shqyrtohet gjatë punës së grupit punues. Atëherë, le t'i dëgjojmë edhe kryesuesit e grupeve punuese, se ku jemi me projektligjet që i kemi në procedurë.

Njomza Emini – Faleminderit kryetare, të nderuar deputetë, përfaqësues të mediave, si dhe ju monitorues që i përcillni punimet e Komisionit tonë!

Nga dëgjimi publik që kemi mbajtur për projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, kanë dalë shumë rekomandime dhe sugjerime, ku ne jemi duke i shqyrtuar dhe mendoj se gjatë punës në grup punues, do të shqyrtojmë mundësinë që t'i inkorporojmë disa ndryshime apo plotësime. Mendoj se kjo kategori e personave me aftësi të kufizuara, ka sfida të shumta, e posaçërisht sa i përket punësimit të tyre në institucionet publike dhe private. Ne do të shqyrtojmë mundësinë që t'i harmonizojmë edhe standardet që i kërkon Bashkimi Evropian, si dhe me mundësitë e vendit tonë. Ne, si grup punues, shumë shpejt do të fillojmë me punën, që të shqyrtojmë këtë projektligj dhe ta procedojmë më tej për miratim, në lexim të dytë. Ju faleminderit!

Kryetarja – Sa i përket kësaj, është mirë që grupet punuese, sa i përket projektligjeve në procedurë, duhet të përshpejtojnë punën e tyre dhe t'i përfundojmë sa me parë. Kurse, sa i përket sugjerimeve apo rekomandimeve që kanë ardhur, është mirë që t'i trajtoni dhe të shqyrtoni mundësinë e inkorporimit të tyre.

Ju njoftoj se për Ditën Ndërkombëtare të Autizmit, unë kam qenë në Shqipëri, ku është shënuar kjo ditë, në mënyrë dinjitoze. Po ashtu, është hapur Qendra e Autizimit. Ne jemi dakorduar, që në muajin shtator, edhe Komisioni ynë, i cili është marrë disa herë me çështjen e autizimit, të organizojë një tryezë ku do të trajtohet çështja e autizmit në Kosovë. Pra, së bashku edhe me dy komisionet, Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione, si dhe Komisionin për Arsim, Shkencë, Teknologji, Rini dhe Sport, të organizojmë një konferencë që të zgjojë vetëdijesimin e popullatës dhe të kontribuojmë në mbledhjen e fondeve për një qasje ndryshe ndaj personave me autizëm.

Kurse, sa i përket projektligjit ku unë jam kryesuese e grupit punues, pra për projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04 / L-054, për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre, ne kemi realizuar një takim me përfaqësuesit e familjarëve të kësaj kategorie, ku është diskutuar për këtë nismë dhe prej cilës datë duhet të përcaktohet për njohjen e statusit të dëshmorit. Pra, ata propozojnë një vit, ku kanë mbledhur edhe shënime për këta persona, mirëpo kjo mbetet që në grup punues të përcaktohet periudha. Sipas tyre, janë diku 245 persona të evidentuar, që kanë rënë si dëshmorë për lirinë e atdheut, kurse personat që kanë pësuar lëndime apo kanë mbetur invalidë gjatë kësaj periudhe, janë diku afërsisht 250 persona. Ne, si grup punues, kemi vlerësuar se kemi nevojë për angazhimin e një eksperti për përgatitjen e dokumenteve për nismën ligjore dhe përgatitjen e draft-projektligjit, ku do të përfshihet edhe kjo kategori. Atëherë, kalojmë te projektligji tjetër, Projektligji për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuesve dhe punëdhënësve, ku z. Fadil Beka e kryeson grupin punues, i cili sot nuk është këtu. Mirëpo, të gjithë ne kemi qenë në grupin punues, që kemi mbajtur për këtë projektligj dhe është duke vazhduar mirë. Besojmë se shumë shpejt do të përfundojë.

Hatim Baxhaku – Sa i përket Projektligjit për shërbimin mjekësor emergjent, ne kemi punuar mjaft dhe jemi në proces të realizimit të një vizite zyrtare në Turqi, dhe pas kthimit nga Turqia, besoj se shumë shpejt do të përfundojmë. Pasi që kanë mbetur vetëm disa çështje, pra sa i përket organizimit dhe koordinimit institucional.

Kryetarja – Ju faleminderit për raportimin, andaj kërkoj nga ju që të shqyrtoni mundësinë, që të intensifikoni punën në grupe punuese, në mënyrë që t'i përfundojmë sa më shpejt këto projektligje, që i kemi në procedurë. Atëherë, po kalojmë te shqyrtimi i pikës së katërt të rendit të ditës.

4. Përzgjedhja e ekspertit për projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04 / L -054, për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre

Kryetarja – Ashtu siç e potencova, ne si grup punues, njëherazi edhe Komisioni ka vendosur që të angazhojmë një ekspert për këtë projektligj, në mënyrë që të na ndihmojë në këtë nismë ligjore në përgatitjen e dokumenteve të nevojshme në aspektin ligjor. Para jush, keni tre kandidatë dhe CV-të e tyre, andaj nëse keni edhe ndonjë propozim nga ana juaj, urdhëroni. Jo. Atëherë votojmë. Ne pasi jemi konsultuar me dy nënkryetarët dhe pasi që e pamë edhe përvojën e z. Emrush Ujkani, i cili kishte një ekspertizë, pasi që kishte punuar në shumë projektligje, si ekspert, ne e konsideruam si ekspert që mund ta angazhojmë, me qellim që ta procedojmë sa më shpejt këtë nismë ligjore. Atëherë, a ka dikush diçka të shtojë? Urdhëroni nënkryetare, Njomza Emini.

Njomza Emini – ju faleminderit kryetare! Unë i kam lexuar biografite e tre kandidatëve dhe mendoj se të tri propozimet kanë qenë të mira, mirëpo unë mendoj se z. Emrush Ujkani, me përvojën që ka prezantuar, që ka punuar si ekspert në shumë projektligje, konsideroj se e përmbush edhe nevojën tonë, si Komision.

Kryetarja – A ka dikush tjetër të shtojë diçka? Jo. Atëherë votojmë. Komisioni, pas diskutimeve dhe votimit, nxori këtë:

V e n d i m

1. **Z. Emrush Ujkani**, angazhohet për kohë të shkurtër, si ekspert i jashtëm për Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04 / L-054, për statusin dhe të drejtat e

dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre.

2. Ngarkohet grupi punues dhe koordinatori i Komisionit, që brenda 3 ditësh pune, të përgatisin termat e referencës, ku definojnë përgjegjësitë e ekspertit, kushtet e kompensimit dhe afatet kohore për dorëzimin e ekspertizës në Komision.

5. Të ndryshme

Kryetarja – Ju njoftoj se kemi një ftesë nga Ministria e Shëndetësisë, për të marrë pjesë në takim të enjten, më 7 prill 2016, pra në takimin e këshillit përgatitor për themelimin e Fondit për Sigurimet Shëndetësore. Në këtë takim do të prezantohen të arriturat e deritanishme në Fond, si dhe nevoja për amendamentimin e Ligjit për sigurime shëndetësore.

Kryetarja – Ju falënderoj për kontributin tuaj!

Mbledhja përfundoi në orën 11:55.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Flora BROVINA